

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË  
KORPORATËN ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare Sh.a., me objekt “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën 04.01.2011 deri më datë 31.12.2011 ., dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 83 datë 06.06.2012. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 179/5, datë 06.06.2012, dërguar Administrator i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare Sh.a, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË  
LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Nga auditimi i zbatimit të ligjeve, ka rezultuar se nga Enti Rregullator i Energjisë, Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Këshilli i Ministrave, të ndërmerren ndryshime thelbësore në Ligjin “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, në Modelin e Tregut dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, pasi:

Importi i energjisë elektrike paraqet për KESH SHA kosto shumë të mëdha financiare, të cilat bazuar në skemën përkatëse të funksionimit të Modelit dhe Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, janë të papërballueshme nga ana e Koorporatës të cilat kanë shkaktuar kolaps financiar, reflektuar në mungesë likuiditetesh për të paguar importin e energjisë si dhe për të përballuar shpenzimet e domosdoshme operative dhe ato lidhur me investimet.

Kostoja financiare e importit të energjisë është e pamundur të përballohet nga KESH SHA, pasi energjia elektrike që prodhohet nga kaskada jo vetëm i shitet CEZ Shpërndarje SHA, me çmim të rregulluar, të miratuar nga ERE, por nga ana tjetër nuk i paguhet nga CEZ Shpërndarje SHA, sipas kontratës të lidhur midis palëve.

***Për këto arsye propozojmë:***

Procedurat e importit të energjisë elektrike të kryhen nga një agjenci e specializuar jashtë korporatës (në varësi të METE-s ose KM), e cila të ndjekë dhe realizojë importin e energjisë elektrike për plotësimin e nevojave të klientëve tarifore. Kjo agjenci të ketë gjithashtu edhe mundësinë të specializohet në marketingun apo tregtimin e energjisë elektrike me tepër se Divizioni i Furnizimit Publik me Shumicë.

Në këtë kuadër krijimi i një agjencie me objekt të veçantë, specifik, për importin dhe eksportin e energjisë elektrike, jo vetëm që do të ndikonte pozitivisht në performancën e KESH, por do të bënte që vendi të jetë më mirë i integruar dhe konkurrues jo vetëm në tregun rajonal të energjisë elektrike por edhe më gjerë. Agjencia të ketë aftësitë e duhura profesionale për të marrë pjesë në tregun spot që zhvillohet në vende të ndryshme të Europës.

Një problem tjetër që kërkon vëmendjen e ERE, METE dhe KM është sigurimi i kapaciteteve të interkonjeksionit.

KESH SHA me qëllim plotësimin e nevojave të CEZ Shpërndarje SHA, për konsumatorët tariforë kishte kapacitete të rezervuara, të cilat i përfitonte pa pagesë, në masën 25 % të kapaciteteve të importit të energjisë elektrike.

Aktualisht KESH SHA i janë hequr tërësisht këto kapacitete të cilat nxirren në ankand nga OST SHA.

KESH SHA i është drejtuar Entit Rregullator të Energjisë; Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si dhe Këshillit të Ministrave, që të vazhdojë ti përfitojë këto kapacitete por ERE nuk i ka marrë parasysh këto kërkesa, pasi e ka konsideruar shitjen totale të kapaciteteve të transmetimit, procedurë ankandit, si detyrim që përcaktohet nga Direktivat e Bashkimit Europian për sektorin e energjisë elektrike.

Sigurimi i blerjes së energjisë nëpërmjet ankandëve të zhvilluara nga OST SHA, të kapaciteteve të interkoneksionit, me numër të kufizuar shoqërisht tregtare, ka sjellë rritje të çmimit/njësi, për importin e energjisë elektrike apo ulje të çmimit/njësi, për eksportin e saj, për rrjedhojë propozojmë:

Agjencia të ketë objekt të veprimtarisë, sigurimin e kapaciteteve të interkoneksionit, nëpërmjet ankandëve të organizuara nga OST SHA.

Në vlerësimin tonë, propozimet për ndryshime në Ligjin “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, në “Modelin e Tregut” dhe “Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike”, do të sillnin ndikim pozitiv në të gjithë sektorin e energjisë elektrike, do të krijonin më shumë konkurrencë dhe mundësi për zhvillimin e tregut të energjisë elektrike si dhe integrimin e tij jo vetëm në tregun rajonal të energjisë elektrike por edhe më gjerë.

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

1. KESH SHA të marri masa për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme të Funkcionimit, përmirësimin e objektivave të përgjithshme, përcaktimin e drejt të aktivitetit dhe rolit të saj, detyrat dhe përgjegjësitë në bashkëpunimin midis Divizioneve dhe Departamenteve, aparatit qëndror dhe njërive prodhuese si dhe të reflektojë ndryshimet në strukturën e KESH-it.

*Deri më 30.06.2012*

2. KESH SHA të dërgojë në METE, në cilësinë e përfaqësuesit të pronës shtetërore, Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës, në zbatim të pikës 8, të VKM nr. 642, datë 11.05.2008 dhe pikës 7 të Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009 “Emërimi, funksionimi dhe shpërblimin e këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”.

*Vazhdimisht*

3. Të revokohet neni 6, paragrafi 5, i Statutit të Shoqërisë, ku përcaktohet se “Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, nuk mund të marrin pjesë në më shumë se 3 këshilla”, pasi ky përcaktim është në kundërshtim me germën a, pika 2, neni 156, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me pikën 3, të VKM nr. 642, datë 11.10.2005, në të cilën citohet: “Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, miratohen nga Ministri i METE dhe i njëjti person nuk mund të zgjidhet në më shumë se 2 Këshilla Mbikëqyrës”, VKM nr. 215, datë 28.03.2012 si dhe Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të deklarojnë me shkrim pjesëmarrjen në Këshillat Mbikëqyrës.

## ***Menjëherë***

4. Projekt -vendimet, urdhrat , udhëzimet, manualët etj., të paraqitura për miratim të Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë t'i nënshtrohen paraprakisht një vlerësimi dhe asistencë juridike, nga struktura përkatëse në KESH, me qëllim që vendimet e marra nga organet drejtuese të jenë në formë dhe përmbajtje, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore përkatëse.

## ***Vazhdimisht***

5. KESH Sh.a.; të përmirësojë metodologjinë e hartimit të programeve të zhvillimit ekonomiko-financiar, të bëjë analiza dhe vlerësime të hollësishme tekniko-ekonomiko-financiare, në mënyrë që të shmangen në maksimum ndryshimet e pjesshme të programit të zhvillimit, regjistri i parashikimit të prokurimeve të jetë pjesë përbërëse e programit ekonomik, për të mos krijuar shkoputje në realizimin e programit të investimeve dhe shërbimeve.

## ***Vazhdimisht***

6. Administratori i shoqërisë të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos realizimin e investimeve mbasi niveli shumë i ulët i realizimit.

## ***Vazhdimisht***

7. Të regjistrohen në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme objektet që janë regjistruar në zërin kadastral “toka” dhe “ndërtesa”, sipas kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ndryshuar me ligjin nr. 9407, datë 19.5.2005.

## ***Menjëherë***

8. KESH SHA të përgatisë dokumente standart për organizmin dhe procedurat kontabël, të nevojshme për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditimit.

## ***Menjëherë***

9. Administratori të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, për gjendjen e lartë të inventarëve në vlerën 2,857,509 mijë lekë, në fund të vitit 2010, vlerë e cila është e pajustificuar me objektin e veprimtarisë dhe krijon rrisht për Korporatën.

## ***Vazhdimisht***

10. Të manaxhohen në mënyrë korrekte likuiditetet e korporatës si dhe të shikohet mundësia e mobilizimit të tyre në instrumente afatshkurtra investimi.

## ***Vazhdimisht***

11. Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojnë shpenzimet për gjoba dhe penaltete, të nxjerrin përgjegjësitë ndaj punonjësve për veprimet dhe mosveprimet, në zbatim të dispozitave ligjore, nënligjore e rregullative, pasi konstatojmë se për vitet 2010-2011, Korporata është ndëshkuar me gjoba e dëmshpërblime në shumën të konsiderueshme nga gjykata, organet përmbartimore dhe administrata tatimore etj. Shpenzimet për gjoba e penaltetet janë pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të strukturave drejtuese e vartëse të Korporatës, duke shkaktuar

shpenzime të tepërta e të pa nevojshme për KESH SHA, të cilat janë në vitin 2010, në vlerën 518,810 mijë lekë, dhe në vitin 2011, në vlerën 492,951 mijë lekë .

*Menjëherë*

**12.** Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojnë pasqyrat financiare të Korporatës, në lidhje me shpenzimet e pa njohura për vitin 2010, në vlerën 786,011 mijë lekë, dhe për vitin 2011 në vlerën 826,246 mijë lekë, duke i kushtuar vëmendjen e duhur këtyre shpenzimeve, me qëllim zvogëlimin dhe eliminimin e tyre.

*Vazhdimisht*

**13.** Të merren masa konkrete duke koordinuar punën me strukturat përkatëse për përmirësimin e dokumentacionit, me qëllim evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme në rrugë administrative, gjyqësore e përmbartimore të debitorëve, për arkëtimin e këtyre vlerave në korporatë, pasi konstatojmë se vlera e arkëtimit të “llogarive të arkëtueshme e të tjera”, për vitin 2010, është 30,017,583 mijë lekë dhe për vitin 2011, është 26,551,789 mijë lekë.

*Vazhdimisht*

**14.** Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, të shqyrtojnë detyrimet e korporatës ndaj kreditorëve, pasi gjendja e llogarisë “të pagueshme dhe të tjera” në fund të vitit 2010, është në vlerën 13,064,372 mijë lekë dhe në fund të vitit 2011, në vlerën 6,574,974 mijë lekë, nga e cila llogaria “furnitorë”, për vitin 2010 është në vlerën 1,033,499 mijë lekë, dhe për vitin 2011 në vlerën 6,574,974 mijë lekë,

*Vazhdimisht*

**15.** Administratori, Këshilli Mbikëqyrës dhe METE të analizojnë detyrimet e KESH SHA ndaj bankave të nivelit të dytë në lidhje me kreditë, të cilat për vitin 2010, janë në vlerën 52,060,300 mijë lekë, dhe për vitin 2011 në vlerën 68,962,952 mijë lekë, duke hartuar strategji dhe politika të menaxhimi të kredive të cilat të sigurojnë stabilitet financiar dhe të mundësojnë zbatimin e objektivave për investime në Korporatë.

Të mendohet si opion ristrukturimi i kredive, si dhe ndërhyrjet e qeverisë për të krijuar fonde garancie për këtë situatë nga buxheti, pasi mungesa e likuiditeteve krijon rrishtje që Korporata dhe Qeveria të penalizohet nga Bankat për kreditë e marra sipas nenit 8 të kontratës së kredisë “Ripagimi i Kredisë” pika 8.1 dhe 8.2, sepse KESH SHA ka hyrë në një periudhë të vështirë financiare.

*Vazhdimisht*

**16.** Të revokohet urdhri i Ministrit të METE nr. 22323, datë 09.03.2012, mbi emërimin e ekspertëve kontabël të regjistruar për auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe të konsoliduara të KESH SHA për ushtrimin e mbyllur të vitit 2011, pasi Korporata auditohet nga audituesit e pavarur ndërkombëtar, në zbatim të marrëveshjeve të huave të lidhura nga Qeveria Shqiptare dhe Donatorët e Huaj, me qëllim eliminimin e dublimeve të shpenzimeve për të njëjtin shërbim, pasi konstatohet se në vitin 2010 për të njëjtin shërbim KESH SHA, ka lidhur kontratën nr. 1844, datë 12.04.2011 në vlerën 14,000 mijë lekë, pa TVSh, me Ekspertët Kontabël të Miratuar dhe nr. 1064/5, datë 20.05.2011 në vlerën 4,120 mijë lekë, pa TVSh, me kompaninë Grant Thornton Albania & Grant Tharton doo Shkup.

*Vazhdimisht*

**17.** KESH SHA, të plotësojë me dokumentacion pagesat e kryera për sponsorizime, reklamë e publicitet, pritje përcjellje etj, konformë ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006, Kreu II, neni 6, pasi konstatohet se në 4 raste, në vlerat 889 mijë lekë dhe 58,000 euro, dokumentacioni nuk është i plotë.

*Vazhdimisht*

**18.** Të reduktohen shpenzimet për reklamë dhe publicitet për vitet në vazhdim, pasi sipas objektit të veprimtarisë Korporata s`ka konkurrencë nga shoqëri të tjera analoge dhe vlerat e përdorura për reklamë dhe publicitet, nuk krijojnë vlerë të shtuar e për rrjedhojë janë të panevojshme.

*Vazhdimisht*

**19.** Drejtoria e shoqërisë të shikojë mundësinë e uljes së numrit të punonjësve, për të arritur një nivel të pranueshëm të shpenzimeve, i cili pasqyrohet në kostot operative.

*Vazhdimisht*

**20.** Autoriteti Kontraktor, të likuideojë faturat e kontraktuesve në zbatim me Kushtet e Veçanta të Kontratës, neni 6 Kushtet e Pagesës pika 6.1, pasi moszbatimi i kontratës krijon risk për pagesa të tepërta nga Korporata.

*Vazhdimisht*

**21.** Të informohen në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse shoqëritë tregtare dhe prodhuese të rajonit lidhur me tërësinë e elementeve që kanë të bëjnë me kushtet teknike, sasinë, çmimet e shit-blerjes, lëvrimin, kapacitetet e interkonjeksionit si dhe tarifatat apo pagesat e tjera që shoqërojnë transaksionin e importit, eksportin dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, me qëllim rritjen e transparencës së këtyre procedurave. Të kërkohet nga autoriteti blerës, dokumentacioni i nevojshëm administrativ i cili vërteton se tregtari nuk është në proces falimentimi, nuk është i dënuar për vepër penale, nuk është i dënuar me vendim të gjykatës për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të nenit 10, të Rregullores së ERE nr. 30, datë 23.03.2011 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH SHA, së energjisë elektrike nga tregtarët vendas dhe të huaj”.

*Vazhdimisht*

**22.** Të kryhen analiza e studime shkencore, në lidhje me programimin e kërkesës për energji elektrike për vitet në vazhdim, për të përcaktuar saktë sasinë e importit apo eksportit të energjisë elektrike.

*Vazhdimisht*

**23.** Të likuidohen me përparësi kontratat e shitblerjes së energjisë për vitin 2011, në vlerën 38,971,756 Euro, nga të cilat 1,678,833 Euro, për muajin Tetor viti 2011, dhe 21,446,837 Euro, për muajin Dhjetor, viti 2011, pasi krijon rrisht për penalizim të Korporatës.

*Vazhdimisht*

**24.** Njësia e Auditit të Brendshëm, të programojë misione, angazhime në funksion të analizës dhe vlerësimit të riskut.

*Vazhdimisht*

**25.** Njësia e Auditit të Brendshëm, të hartojë dhe të mbajë një program që të sigurojë cilësinë e auditimeve të kryera dhe të vlerësojë veprimet e njësisë së auditimit të brendshëm sipas standardin 1310 të IIA-së.

*Vazhdimisht*

**26.** Administratori i KESH Security SHA, të bëjnë rishikimin e pagave duke llogaritur shtesën e pagës për çdo vit vjetërsi në punë, për të gjithë punonjësit.

*Menjëherë*

**27.** Të studiohen mënyra të tjera të organizimit, në lidhje me shoqërinë bijë KESH Security SHA, një ndër to është prokurimi i këtij shërbimi, me qëllim minimizimin e humbjeve, pasi konstatohen masa të pamjaftueshme për reduktimin e shpenzimeve, që për pasojë sjellin rritjen e kostos në tërësi dhe të tarifës së shërbimit për një punonjës shërbimi që kërkohet të përballohet nga KESH –i .

*Vazhdimisht*

**28.** Administratori i KESH SHA dhe organet drejtuese të KESH Security SHA si dhe organet drejtuese të njësive HEC Vau i Dejës, HEC Fierzë, të analizojnë me përgjegjshmëri shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara nga Auditi i Brendshëm i Korporatës, si dhe të marrin masa disiplinore dhe administrative ndaj personave përgjegjës.

*Menjëherë*

**29.** Korporata të përqendrohet krahas përcaktimit të misionit, strategjisë dhe objektivave, në hartimin e planeve konkrete të veprimit, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre. Në planin e veprimeve të korporatës duhet të përfshihen hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së përfshirë manaxhimin e riskut në linjë me hartimin e programin ekonomik.

*Vazhdimisht*

**30.** Administratori i KESH SHA, për ngjarjen e denoncuar në emisionn “FIKS FARE”, më datën 12.03.2012, për vjedhje të skrapeve në objektin TEC Fier, duhet të nxjerrë përgjegjësinë ndaj strukturave drejtuese e vartëse të KESH Security SHA.

*Menjëherë*

**31.** Të revokohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës së TEC Vlorë SHA mbi emërimin në detyrën e Administratorit të Shoqërisë të z. Kasem Mahmutaj, pasi gjatë kontrolleve të ushtruar nga KLSH në Portin Detar Vlorë SHA, janë konstatuar një sërë shkeljesh të administrimit të shoqëruara me dëme ekonomike, për të cilat KLSH ka depozituar në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, kallëzimin nr. 148/15, datë 10.02.2012, për konsumim të elementëve të veprës penale “shpërdorim i detyrës”.

*Menjëherë*

### **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

1. T'i kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi në vlerën **7,988,644 mijë lekë**, për mos likuidimin e energjisë elektrike të furnizuar, për periudhën nga privatizimi i OSSH-së deri më datë 31.12.2011, si dhe të vlerës **976,567 mijë lekë**, dëm ekonomik, si rrjedhojë e aplikimit të normës së interesit për faturat e pa likuiduara CEZ Shpërndarje SHA, në zbatim të kontratës dypalëshe, trajtuar në faqen 87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **54,716,275 lekë**, (penalitet) i llogaritur deri më datë 23.03.2012, nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] e cila përbën dëm ekonomik për moszbatim të grafikut të punimeve sipas kontratës nr. 7536/17, datë 04.03.2011, me objekt "Punime emergjente në anën e poshtme të H/C Fierzë" dhe nenit 33, pika 33.1-33.5, të kushteve të përgjithshme të kontratës të miratuar në DST, trajtuar në faqen 84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **D. MASA ADMINISTRATIVE**

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e zhvilluar për vitin 2011, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar për çdo procedurë, bazuar në nenin 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikës 3, kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, i kërkojmë Agjencisë së Prokurimit Publik **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke rekomanduar marrjen e masave administrative e disiplinore për punonjësit:

1. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e juristit në njësinë e prokurimit;
2. zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e specialistes së njësinë e prokurimit;
3. zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e specialistes së njësinë e prokurimit;
4. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit;
5. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit;
6. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit;
7. zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e specialistes së njësinë e prokurimit.
8. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit;
9. zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e juristit në njësinë e prokurimit;

Për arsye se:

Për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kanë kërkuar që operatorët ekonomik/ofertuesit nuk duhet të kenë detyrime ndaj KESH SHA, pa përcaktuar vlerën e detyrimit, në kundërshtim me nenet 46 e 53, ku përcaktohet se kriteret kualifikuese duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese, trajtuar më hollësisht në faqet 51-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**10. z. [REDACTED]**, në cilësinë Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit”, ka kualifikuar operatorin ekonomik/ofertuesit e paraqitur në procedurën me objekt: “Riparim, mirëmbajtje dhe vendosje pjesë këmbimi të automjeteve të KESH SHA për periudhën një vjeçare”, me vlerë limit të kontratës 46,840 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 07.02.2011, trajtuar më hollësisht në faqet 51-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**11. z. [REDACTED]**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave;

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit” ka kualifikuar operatorët ekonomik/ofertuesit të cilët kanë paraqitur ofertë në procedurat me objekt:

- “Riparim, mirëmbajtje dhe vendosje pjesë këmbimi të automjeteve të KESH SHA për periudhën një vjeçare”, me vlerë limit të kontratës 46,840 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 07.02.2011.

- “Blerje Automjete për nevojat e KESH SHA”, me vlerë limit të kontratës 65,100 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 08.04.2012.

- “Rikonstruksion i urës lidhëse të tuneleve të shkarkimit dhe ambienteve të jashtme të kullave të tuneleve të shkarkimit Nr. 3 dhe Nr. 4”, me vlerë limit të kontratës 62,042 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 20.04.2011, trajtuar më hollësisht në faqet 52-53, 61-63 dhe 71-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**12. znj. [REDACTED]**, në cilësinë e anëtares së KVO

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit”, ka kualifikuar operatorët ekonomik/ofertuesit e paraqitur në procedurat me objekt:

- “Riparim, mirëmbajtje dhe vendosje pjesë këmbimi të automjeteve të KESH SHA për periudhën një vjeçare”, me vlerë limit të kontratës 46,840 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 07.02.2011;

-“Rivlerësimi i plotë i aktiveve afatgjata materiale të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare SHA”, me vlerë limit të kontratës 116,000 mijë lekë, zhvilluar më datë 10.03.2011;

- “Blerje pjesë rezervë për HEC Koman”, me vlerë limit të kontratës 108 312 mijë lekë, zhvilluar më datë 24.08.2011;

-“Punime emergjente në anën e poshtme të H/C Fierzë”, me vlerë limit të kontratës 350,701 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 13.12.2010, trajtuar më hollësisht në faqet 52-60 dhe 78-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit



**13. z. [REDACTED]** në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

**14. z. [REDACTED]**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit”, kanë kualifikuar operatorët ekonomik/ofertuesit e paraqitur në procedurën me objekt: “Rivlerësimi i plotë i aktiveve afatgjata materiale të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare SHA”, me vlerë limit të kontratës 116,000 mijë lekë, zhvilluar më datë 10.03.2011, trajtuar më hollësisht në faqet 53-59, të Raportit Përfundimtar të Audtit.

**15. z. [REDACTED]**, në cilësinë e Kryetarit të KVO;

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit” ka kualifikuar operatorët ekonomik/ ofertuesit e paraqitur në procedurën me objekt: “Blerje Automjete për nevojat e KESH SHA”, me vlerë limit të kontratës 65,100 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 08.04.2012, trajtuar më hollësisht në faqet 61-67, të Raportit Përfundimtar të Audtit.

**16. z. [REDACTED]**, në cilësinë e anëtarit të KVO

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit” ka kualifikuar operatorët ekonomik/ofertuesit e paraqitur në procedurat me objekt:

- “Blerje Automjete për nevojat e KESH SHA”, me vlerë limit të kontratës 65,100 mijë lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 08.04.2011;
- “Blerje Autobuz e Kamion për nevojat e KESH SHA”, me vlerë limit të kontratës 52,930 mijë lekë, zhvilluar më datë 24.04.2011;
- “Blerje kompresorë të presionit të lartë dhe të ulët dhe pjesë rezervë të tyre”, me vlerë limit të kontratës 42, 766.6 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 13.04.2011, trajtuar më hollësisht në faqet 61-71, të Raportit Përfundimtar të Audtit.

**17. z. [REDACTED]** në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit”, ka kualifikuar operatorët ekonomik në procedurat me objekt:  
-“Blerje kompresorë të presionit të lartë dhe të ulët dhe pjesë rezervë të tyre”, me vlerë limit të kontratës 42,766.6 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 13.04.2011.

- “Blerje pjesë rezervë për HEC Koman”, me vlerë limit të kontratës 108.312 mijë lekë, zhvilluar më datë 24.08.2011;
- “Punime emergjente në anën e poshtme të H/C Fierzë”, me vlerë limit të kontratës 350,701 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 13.12.2010, trajtuar më hollësisht në faqet 67-69 dhe 78-84, të Raportit Përfundimtar të Audtitimit.

**18. z. [REDAKTUAR]** në cilësinë Kryetarit dhe e anëtarit të KVO;

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit ka kualifikuar operatorët ekonomik/ofertuesit e paraqitur në procedurat me objekt:

- “Blerje kompresorë të presionit të lartë dhe të ulët dhe pjesë rezervë të tyre”, me vlerë limit të kontratës 42,766.6 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 13.04.2011; - “Blerje Autobuz e Kamion për nevojat e KESH SHA”, me vlerë limit të kontratës 52,930 mijë lekë, zhvilluar më datë 24.04.2011;
- “Rikonstruksion i urës lidhëse të tuneleve të shkarkimi dhe ambienteve të jashtme të kullave të tuneleve të shkarkimit Nr. 3 dhe Nr. 4”, me vlerë limit të kontratës 62,042 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datën 20.04.2011;
- “Blerje pjesë rezervë për HEC Koman”, me vlerë limit të kontratës 108,312 mijë lekë, zhvilluar më datë 24.08.2011;
- “Punime emergjente në anën e poshtme të H/C Fierzë”, me vlerë limit të kontratës 350,701 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 13.12.2010, trajtuar më hollësisht në faqet 67-84, të Raportit Përfundimtar të Audtitimit.

**19. z. [REDAKTUAR]** në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave;

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit” ka kualifikuar operatorët ekonomik/ofertuesit e paraqitur në procedurën me objekt: “Blerje Autobuzi e Kamioni për nevojat e KESH SHA”, me vlerë limit të kontratës 52,930 mijë lekë, zhvilluar më datë 24.04.2011, trajtuar më hollësisht në faqet 69-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**20. [REDAKTUAR]**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit” ka kualifikuar operatorët ekonomik/ofertuesit e paraqitur në procedurat me objekt:

- “Rikonstruksion i urës lidhëse të tuneleve të shkarkimi dhe ambienteve të jashtme të kullave të tuneleve të shkarkimit nr. 3 dhe nr. 4”, me vlerë limit të kontratës 62,042 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 20.04.2011.

- “Blerje pjesë rezervë për HEC Koman”, me vlerë limit të kontratës 108 312 mijë lekë, zhvilluar më datë 24.08.2011, trajtuar më hollësisht në faqet 71-76 dhe 78-80, të Raportit Përfundimtar të Audtitimit.

**21.** ██████████, në cilësinë e anëtarit të KVO;

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit” ka kualifikuar operatorët ekonomik të paraqitur në procedurën me objekt: “Blerje pjesë rezervë për HEC Koman”, me vlerë limit të kontratës 108,312 mijë lekë, zhvilluar më datë 24.08.2011, trajtuar më hollësisht në faqet 78-80, të Raportit Përfundimtar të Audtitimit.

**22. z.** ██████████, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave;

**23. z.** ██████████, në cilësinë e anëtarit të KVO;

Për arsye se:

Në kundërshtim me nenin 53, pika 3 e LPP, kreut V, pika 4, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranimit/kualifikimit”, kanë kualifikuar operatorët ekonomik/ofertuesit në procedurën me objekt: “Punime emergjente në anën e poshtme të H/C Fierzë”, me vlerë limit të kontratës 350,701 mijë lekë, pa TVSh, zhvilluar më datë 13.12.2010, trajtuar më hollësisht në faqet 80-84, të Raportit Përfundimtar të Audtitimit.

## **E. MASA DISIPLINORE**

a) Bazuar në kapitullin VII masat disiplinore, neni 62, pika 4 të kontratës kolektive të punës, e lidhur më datë 30.12.2009, ndërmjet ish Drejtorit të Përgjithshëm të “KESH” SHA, Federatës Sindikale e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë dhe Sindikatë së Pavarur të Punonjësve të Elektroenergjetikës së Shqipërisë, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

### ***“Largim nga puna”***

**1. znj.** ██████████, me detyrë teknike, specialiste eksperte në Sektorin e Administrimit të Detyrimeve të Prapambetura;

**2. z.** ██████████, me detyrë teknik, specialist ekspert në Sektorin e Administrimit të Detyrimeve të Prapambetura;

**3. z.** ██████████ me detyrë teknik specialist, ekspert në Sektorin e Administrimit të Detyrimeve të Prapambetura;

**4. znj.** ██████████ me detyrë teknike, specialiste eksperte në Sektorin e Administrimit të Detyrimeve të Prapambetura.

Pasi:

-Nuk kanë zbatuar detyrat e përcaktuara në rregulloren e funksionimit organizativ dhe legjislacionit përkatës në fuqi për arkëtimin e plotë të faturave të prapambetura të energjisë elektrike, akteve administrative debitoare të kontabilizuara në llogarinë e KESH SHA, të gjobave e dëmeve debitoare të aplikuara nga ish Policia Elektrike dhe Shërbimi i Kontrollit të Energjisë Elektrike, nga klientët, subjektet apo administratorët e objekteve të përdorimit të energjisë elektrike;

- Nuk kanë bërë evidentimin e abonentëve debitoare, saktësinë e adresave dhe vlerën e debisë.

- Nuk kanë përfaqësuar KESH SHA në organet gjyqësore, përmbartimore, administrative apo penale, për aktet administrative të gjobave e dëmeve që janë në proces, si dhe faturave të prapambetura;

- Nuk kanë njohur abonentët, me vlerën totale të debisë së faturave elektrike të kontabilizuara në llogarinë e KESH SHA;

- Nuk kanë bashkëpunuar me subjektin e licencuar, për furnizimin me energji të objekteve/subjekteve apo klientëve debitoare ndaj KESH SHA;

- Nuk kanë bashkëpunuar me Zyrat e Përmbartimit dhe subjektet, strukturat apo organet e tjera kompetente për arkëtimin e plotë të debive nga klientët, objektet/subjektet apo personave fizik e juridik debitoare ndaj KESH SHA.

Trajtuar në faqen 28, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

b) Mbështetur kapitullin VII masat disiplinore, neni 62, pika 2, të kontratës kolektive të punës, e lidhur më datë 30.12.2009, ndërmjet ish Drejtorit të Përgjithshëm të “KESH” SHA, Federatës Sindikale e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë dhe Sindikatë së Pavarur të Punonjësve të Elektroenergjetikës së Shqipërisë, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

### ***“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”***

**1. z. [REDAKTUAR]** me detyrë Zv. Administrator i Korporatës;

-Për moszbatim të udhëzimit të METE nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, në lidhje me mosrealizimin e investimeve dhe shpenzimeve;

- Për të meta e mangësi në zgjidhjen e kontratave të punës, të cilat në 60 raste janë bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të fushës, pasi nuk janë zbatuar procedurat e takimit dhe bisedimit nga ana e punëdhënësit si dhe nuk ka pasur shkaqe të arsyeshme për zgjidhjen e kontratës së punës;

-Për moszbatim të Rregullores së ERE nr. 30, datë 23.03.2011. “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH SHA, së energjisë elektrike nga tregtarët vendas dhe të huaj” ;

-Për të meta e mangësi në prokurimin e fondeve, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, për procedurat e zhvilluara në vitin 2011.

Trajtuar në faqet 15-26, 48 dhe 87-91, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

**2. z. [REDAKTUAR]** me detyrë Drejtori i Departamentit të Divizionit të Gjenerimit;

Për moszbatim të udhëzimit të METE nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, në lidhje me mosrealizimin e investimeve dhe shpenzimeve, trajtuar në faqet 15-26, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

**3. z.** [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Divizionit të Furnizuesit Publik me Shumicë, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të blerjes së energjisë, për procedurat e zhvilluara gjatë vitit 2011.

- Për moszbatim të udhëzimit të METE nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, në lidhje me mosrealizimin e investimeve dhe shpenzimeve;

- Për moszbatim të Rregullores së ERE nr. 30, datë 23.03.2011. “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH SHA, së energjisë elektrike nga tregtaret vendas dhe të huaj”, trajtuar në faqet 15-26 dhe 87-91, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

**4. zj.** [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Departamentit të Tregtimit të Energjisë Elektrike, në Divizionin e Furnizuesit Publik me Shumicë, në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjes së energjisë për procedurat e zhvilluara gjatë vitit 2011;

**5. z.** [REDAKTUAR] me detyrë Përgjigjes i Sektorit Juridik në Divizionin e Furnizuesit Publik me Shumicë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjes së energjisë për procedurat e zhvilluara gjatë vitit 2011;

**6. z.** [REDAKTUAR], me detyrë teknik, specialist, ekspert në Divizionin e Furnizuesit Publik me Shumicë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjes së energjisë për procedurat e zhvilluara gjatë vitit 2011;

Për moszbatim të Rregullores së ERE nr. 30, datë 23.03.2011. “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH SHA, së energjisë elektrike nga tregtaret vendas dhe të huaj”, trajtuar në faqet 87-91, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

**7. z.** [REDAKTUAR] me detyrë ish Drejtor i Departamentit të Prokurimeve;

- Për moszbatim të udhëzimit të METE nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, në lidhje me cilësinë e programeve të zhvillimit.

- Për të meta e mangësi në prokurimin e fondeve për procedurat e zhvilluara në vitin 2011, në lidhje me hartimin e dokumenteve të tenderave në veçanti të specifikimeve të veçanta për kualifikim, trajtuar në faqet 15-26 dhe 51-86, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

**8. zj.** [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e Departamentit të Shërbimeve të Përgjithshme.

- Për moszbatim të Udhëzimit të METE nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, në lidhje me cilësinë e programeve të zhvillimit.

- Për të meta e mangësi në zgjidhjen e kontratave të punës, të cilat në 60 raste janë bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të fushës, pasi nuk janë zbatuar procedurat e takimit dhe bisedimit nga ana e punëdhënësit si dhe nuk ka pasur shkaqe të arsyeshme për zgjidhjen e kontratës së punës, trajtuar në faqet 15-26, 48, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

**9. zj.** [REDACTED] me detyrë Drejtore e Departamentit Ligjor;  
Për të meta e mangësi në zgjidhjen e kontratave të punës, të cilat në 60 raste janë bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të fushës, pasi nuk janë zbatuar procedurat e takimit dhe bisedimit nga ana e punëdhënësit si dhe nuk ka pasur shkaqe të arsyeshme për zgjidhjen e kontratës së punës, trajtuar në faqen 48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**10. z.** [REDACTED] me detyrë Drejtor i Shoqërisë KESH Security.  
Për ngjarjen e publikuar në emisionin “FIKS FARE” më datën 12.03.2012, mbi vjedhje të skrapeve në objektin TEC Fier, pasi kjo shoqëri ka përgjegjësinë administrative e ligjore për ruajtjen e tyre nga dëmtimet, vjedhjet, etj., trajtuar në faqen 103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**11. z.** [REDACTED] me detyrë Drejtor i Njesisë HEC Fierze;

**12. z.** [REDACTED], me detyrë Përgjegjës i Sektorit Ekonomik HEC Fierzë;

**13. zj.** [REDACTED], me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve HEC Fierze;

Sepse nga auditimet e brendshme të korporatës, për vitet 2010-2011, në njësiti e prodhimit HEC Fierzë dhe Vau i Dejës janë konstatuara të meta, parregullsi dhe shkelje të akteve ligjore e rregullative të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Drejtorin e Njesisë dhe Përgjegjësit e Sektorëve Ekonomik dhe Shërbimeve, trajtuar në faqet 98-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**14. z.** [REDACTED], me detyrë Drejtor i Njesisë HEC Vau i Dejës;

**15. zj.** [REDACTED], me detyrë Përgjegjës i Sektorit Ekonomik, Vau i Dejës;

**16. z.** [REDACTED] me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve HEC Vau i Dejës;

Pasi nga auditimet e brendshme të korporatës, për vitet 2010-2011, në njësiti e prodhimit HEC Fierzë dhe Vau i Dejës janë konstatuara të meta, parregullsi dhe shkelje të akteve ligjore e rregullative të cilat ngarkojnë me përgjegjësi drejtorin e njesisë dhe përgjegjësit e sektorëve ekonomik dhe shërbimeve, trajtuar në faqet 98-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

c) Mbështetur kapitullin VII masat disiplinore, neni 62, pika 1, të kontratës kolektive të punës, e lidhur më datë 30.12.2009 ndërmjet ish Drejtorit të Përgjithshëm të “KESH” SHA, Federatës Sindikale e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë dhe Sindikatë së Pavarur të Punonjësve të Elektroenergjetikës së Shqipërisë, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

#### **“Vërejtje”**

**1. z.** [REDACTED], me detyrë Drejtor i Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun;

Për të meta e mangësi në shpenzimet për reklamë-publicitet, trajtuar në faqet 42-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**2. z.** [REDACTED], me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit në DEK.

Për moszbatim të udhëzimit të METE nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, në lidhje me cilësinë e programeve të zhvillimit, trajtuar në faqet 15-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**3. z.** [REDACTED] me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Administrimit të Detyrimeve të Prapambetura: Për arsye se:

-Nuk kanë zbatuar detyrat e përcaktuar në rregulloren e funksionimit organizativ dhe legjislacionit përkatës në fuqi për arkëtimin e plotë të faturave të prapambetura të energjisë elektrike, akteve administrative debitore të kontabilizuara në llogarinë e KESH SHA, të gjobave e dëmeve debitore të aplikuara nga ish Policia Elektrike dhe Shërbimi i Kontrollit të Energjisë Elektrike, nga klientët, subjektet apo administratorët e objekteve të përdorimit të energjisë elektrike;

- Nuk kanë bërë evidentimin e abonentëve debitore, saktësinë e adresave dhe vlerën e debisë.

- Nuk kanë përfaqësuar KESH SHA në organet gjyqësore, përmbarimore, administrative apo penale, për aktet administrative të gjobave e dëmeve që janë në proces, si dhe faturave të prapambetura;

- Nuk kanë njohur abonentët, me vlerën totale të debisë së faturave elektrike të kontabilizuara në llogarinë e KESH SHA;

- Nuk kanë bashkëpunuar me subjektin e licencuar, për furnizimin me energji të objekteve/subjekteve apo klientëve debitore ndaj KESH SHA;

- Nuk kanë bashkëpunuar me Zyrat e Përmbarimit dhe subjektet, strukturat apo organet e tjera kompetente për arkëtimin e plotë të debive nga klientët, objektet/subjektet apo personave fizik e juridik debitore ndaj KESH SHA.

Trajtuar në faqen 28, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

d) Për drejtuesit dhe punonjësit si më poshtë:

**1. z.** [REDACTED], me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm;

**2. z.** [REDACTED], me detyrë ish zv/Drejtor Ekonomik;

**3. zj.** [REDACTED], me detyrë ish Drejtores e Departamentit të Auditit të Brendshëm;

**4. z.** [REDACTED], me detyrë ish Drejtorin e Departamentit Ligjor;

**5. zj.** [REDACTED], me detyrë ish specialiste në Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun;

**6. z.** [REDACTED], me detyrë ish specialist në Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun, është tejkaluar masa disiplinore e përcaktuar në nenin 37, ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar si dhe në nenin 62, kapitullin VII, të kontratës kolektive të punës, të lidhur më datë 30.12.2009, pasi për këta punonjës KESH –i ka marrë masën disiplinore “pushimit nga puna”, **prandaj masa që do të propozonte grupi i auditimit quhet e ezauruar.**

***Lista me emrat e lartpërmendur do t`i dërgohet Departamentit të Administratës Publike (DAP)***

*Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Shefki Jaupi, Andi Buzo, Selman Hysaj, Lavdie Fshazi më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtorin e Departamentit Athanas Karaja, Drejtorin e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtorin e Përgjithshëm Robert Gjini.*

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**